



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1023/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryetar i kolegjit, Krenar Berisha dhe Dren Rogova, anëtare të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Settegusti SA” me seli në Viti, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditurës të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1836/18 të datës 12.05.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.07.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

Aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr.1836/18 të datës 12.05.2022, Prishtet, dhe Lënda i kthehet Gjykatës Komerciale – Dhomave të Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, në pikën I të dispozitivit ka vendosur: Aprovohet si e bazuar Kërkesëpadia e paditësit “Settegusti SA” me seli në Viti, nën pikën II. Anulohet aktvendimi nr.01.3.2.2/204 i datës 10.05.2018 i Doganës së Kosovës. nën pikën III. Obligohet e paditura Dogana e Kosovës, që paditësit, t’ia kthej shumën prej 11,243.12€, të paguara nga paditësi në emër të taksës doganore prej 8%, 6% dhe 4% në vlerë prej 9,527.66€ dhe diferencës së Tatimit mbi vlerën e shtuar prej 18% në vlerë prej 1,715.46€, për mallin e zhdoganuar përmes Deklaratave Unike Doganore me nr. R-6312/18.04.2016, R-4491/30.05.2016, R-6440/22.04.2016, R-7642/25.08.2016, R-9731/14.10.2016, R-10729/21.11.2016, R-11541/14.12.2016, R-794/13.12.2017, R-2030/24.03.2017, R-3421/02.05.2017, R-4872/27.05.2017, R-6375/29.06.2017, R-8418/14.08.2017, R-9986/2309.2017, R-11659/04.11.2017, R-1238/26.02.2018, R-2158/09.02.2018, si rezultat i ndryshimit të kodit tarifor nga kodi me nr.18063100 i deklaruar nga paditësi, në kodin tarifor me nr.1806903100 të ndryshuar nga e paditura të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 04.04.2018 si datë e paraqitjes së ankesës tek e paditura e deri në pagesën e plotë të kësaj shume në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën pikën IV. Secila palë ndërgjyqëse i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar e paditura me të cilin e konteston ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të; zbatimit të gabuar të drejtës material, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje esenciale të dispozitave të procedurës LKA-së, me propozim që të aprovon ankesën në tërësi si të bazuar në ligj, të prish Aktgjykimin A.nr.1836/18 i datës 12.05.2022 si të pa bazuar në ligj, ta refuzon padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të pa bazuar me ligj dhe ta lë në fuqi aktvendimin e kontestuar, ose t'ia kthej gjykatës në rishqyrtim dhe rivendosje. Gjykata e shkallës së parë në këtë çështje nuk ka vërtetuar saktë gjendjen faktike. Arsyetimi i aktgjykimit bazohet në ekspertizën e eksperti financiar, ku theksohet se eksperti financiar ka dhënë mendimin dhe konstatimin se përshkrimi i mallit ka të bëjë me mall “çokollada në blloqe” që është e saktë se kemi të bëjmë me çokollada në blloqe dhe determinon se të njëjtat i takojnë pozicionit tarifor 18063100 dhe 18063200 të mbushura dhe jo të mbushura dhe që është dhënë në TARIK, dhe në bazë të këtij mendimi eksperti ka konstatuar se paditësi ka deklaruar saktë numrin tarifor. Ky konstatim i gjykatës është i pa bazuar sepse bazohet në një ekspertizë të ekspertit financiar, i cili nuk është kompetent që të jep mendime në lidhje me numrin tarifor. Andaj te provuarit me ekspert jo kompetent në këtë çështje nuk mund të konsiderohet provë relevante juridike sepse eksperti ka qenë i lëmis financiare e jo ekspert në fushën e klasifikimit tarifor të mallrave.

Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar, si në vështrim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 dhe nenit 49 i LKA-së, në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e **bazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me aktvendimin nr. 01.3.2.2/204 të datës 10.05.2018, e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë paditësit “Settegusti SA” me seli në Viti, për rishqyrtimin e aktvendimit numër nr. 03.1.1-2017-232 të datës 02.03.2018 të lëshuar nga Sektori i Kontrollës Pas Importuese, si e pa bazuar.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit të lart cekur, si dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të seancës së shqyrtimit kryesor datës 12.05.2022, e duke u bazuar edhe ekspertizën financiare, bie Aktgjykimin e ankimuar me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit, jepen vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës, se për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor gjykata me propozimin e të autorizuarit të paditësit në seancën gjyqësore të datës 14.01.2022 ka caktuar ekspertizë financiare në këtë konflikt administrativ. Nga vlerësimet dhe konstatimet e nxjerra të ekspertit financiar E.P. në ekspertizën financiare të datës 23.03.2022 dhe të paraqitura edhe në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 12.05.2022 për vëllimin dhe lëndën e ekspertizës është dhënë konstatimi dhe mendimi profesional se malli prezantuar për zhdoganim në nomenklaturën e TARIK-ut për vitin 2018 përshkrimi i mallit ka të bëjë me mall “çokollata në blloqe” që është e saktë se kemi të bëjmë me çokollata në blloqe dhe determinon se të njëjtat i takojnë pozicionit tarifor 18063100 dhe 8063200 të mbushura dhe jo të mbushura dhe që është dhënë në TARIK. Sipas ekspertit nga këto ndryshime të kodit tarifor, rrjedh që kompania “Settegusti SA” Dega në Kosovë – Viti, ka paguar më tepër taksën e doganës në lartësi prej 9,527.66€ dhe taksën

e TVSH-së në lartësi prej 1,715.46€ që në total më tepër ka paguar në shumë prej 11,243.12€. Eksperti Financiar në seancë ka bërë plotësimin e ekspertizës financiare të datës 23.03.2022 ashtu që ka deklaruar se llogaritja e kamatëvonesës e cila është bërë me ekspertizë largohet nga ekspertiza dhe në këtë rast si vlerë e paguar nga paditësi si rezultat i ndryshimit të kodit tarifor për mallin e zhdoganuar nga paditësi mbetet vlere prej 11,243.12€. Sa i përket përgatitjes profesionale ekspertit financiar ka deklaruar se ka të përfunduar Fakultetin Ekonomik në UP, është i certifikuar si auditor ligjor në Ministrinë e Financave, i njëjti është trajner i certifikuar lidhur me kornizën afatmesme të shpenzimeve buxhetore (KASH) dhe së fundmi është certifikuar si trajner në Akademinë e Drejtësisë për lëndën specifike të sistemit tatimor dhe doganor të Kosovës, me konkretisht temën procedurat me ndikim ekonomik dhe ka një përvojë mbi 16 vite, në auditim, financa dhe kontabilitet. Gjykata ja falë besimin të njëjtës ekspertizë sepse ishte në harmoni me shkresat e lëndës dhe legjislacionin doganor të aplikueshëm dhe Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit.

Dhomat e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes dhe duke shqyrtuar vendimet e organit të paditur, aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, gjen se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 183, dhe zbatim i gabuar i të drejtës materiale nga neni 184 i LPK-së, dhe si tillë është jo i plotë.

Kolegji, i Dhomave të Shkallës së Dytë, shqyrtoi me kujdes shkresat e lëndës, dhe erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë vendimin e saj e ka nxjerr duke mos e zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitën ligjore nga neni 183 të LPK-së, me të cilën përcaktohet se: *Ekziston vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike kur gjykata gabimisht e ka vërtetuar ndonjë fakt vendimtar, përkatësisht kur faktin e tillë nuk e ka vërtetuar fare.* Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike nga dokumentacioni i lëndës, ka marrë për bazë ekspertizën e ekspertit financiar që mbështesin konkludimin se malli lëndor është deklaruar saktë me kodin tarifor. Gjithashtu Kolegji gjen se gjykata e shkallës së parë zbaton në mënyrë jo të drejtë dispozitat ligjore që bie ndesh me nenin 184 të LPK-së ku përcaktohet se: *Zbatimi i gabueshëm i së drejtës materiale ekziston kur gjykata nuk e ka zbatuar dispozitën e së drejtës materiale që është dashur ta zbatojë, apo kur dispozitën e tillë nuk e ka zbatuar në mënyrë të drejtë.* Kolegji e konsideron të bazuara përfundimet e të paditurës të parashtruara në ankese se eksperti financiar nuk është përgatitje profesionale lidhur me përcaktimin e kodit tarifor për mallin lëndor. Kolegji e konsideron papranueshme caktimin e një eksperti financiar për të vërtetuar saktë klasifikimin tarifor për mallin lëndor, pasi një ekspert i tillë nuk i përket lëvizjes përkatëse lidhur me objektin e kontestit përkatësisht nuk mund të vërtetojë në mënyrë të drejtë dhe reale gjendjen faktike e cila është objekt kontesti.

Duke u nisur nga kjo gjende e tillë e çështjes kolegji i kësaj gjykate ka gjetur se nuk mund të pranohet konkludim juridik i gjykatës së shkallës së parë, si i drejtë dhe i ligjshëm sepse sipas vlerësimit të kësaj gjykate, për shkak të mos vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike gabimisht është zbatuar edhe e drejta materiale, prandaj është dashur që aktgjykimi i goditur të priset dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Bazuar në të lartëcekurat, rezulton se gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e atakuar e ka marrë me shkelje të nenit 8 të LPK-së, për arsye se nuk i ka vlerësuar me kujdes të veçantë secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku. Sipas Nenit 8.2 të LPK-së, gjykata ka për obligim që me ndërgjegje dhe

me kujdes ta çmojë çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku për të ardhur te e vërteta materiale. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka marrë vendimin e atakuar, pa qartësuar plotësisht gjendjen faktike dhe juridike të çështjes. Shkeljet e tilla përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që kanë pasur ndikim në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë andaj aktgjykimi i atakuar, doemos është dashur të priset.

Në ri procedurë Dhomat e shkallës së parë, duhet ti shqyrtojë të gjitha vërejtjet e dhëna nga Kolegji i kësaj gjykate, të shqyrtoj me kujdes dispozitat e legjislacionit doganor, si dhe provat që janë nxjerr gjatë procedurës administrative, ashtu që me rastin e vendim marrjes. Dhomat e shkallës së parë sipas nevojës dhe kërkesave të palëve ndërgjyqëse, të siguroj prova përmes ekspertizës në lëmin përkatëse, me qëllim të konstatimit të saktë të klasifikimit tarifor të mallit kontestues.

Nga te cekurat me lart, e në mbështetje të nenit 195 parag. 1 pika (c) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1023/22 me datë 13.07.2023

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari
Ramush Bardiqi